

VENDIM
Nr. 98, datë 9.5.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“H&K@VALA MAR RESIDENCES” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 608/2 prot., datë 28.4.2022, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘H&K@VALA Mar Residences’ sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “H&K@Vala Mar Residences” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 570 prot., datë 15.4.2022, ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal, si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”, plotësuar;
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”, plotësuar;
- Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7, germat: “a”, “c”, “d”, “f” dhe “h”, plotësuar;
- Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:
Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7:
 - germa “b” (kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj).

Shoqëria nuk ka depozituar dokumentacion mbështetës ku të vërtetohet që e disponon të gjithë shumën që ka deklaruar për mbështetjen e veprimtarisë;

- germa “e” (sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi).

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE marrëveshjen për sistemin IT për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, duke qenë se ka bërë me dije se ka filluar punën për të siguruar mbështetjen me infrastrukturën e nevojshme të një sistemi të integruar të proceseve kryesore të biznesit aktual, ose

marrëveshje me tregtarë aktivë në treg për të siguruar (*outsource*) shërbimet e skedulimit dhe të tjera që lidhen me veprimtarinë e furnizimit, derisa shoqëria të krijojë kapacitetet e veta;

- germa “g” (dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve). Shoqëria duhet të bëjë saktësimin e disponimit të këtyre zyrave dhe kohën kur do t’i disponojë ato, referuar faktit që ka bërë me dije se objekti është në ndërtim;

- germa “i” (niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët). Shoqëria duhet të bëjë me dije dhe nivelin e tensionit të parashikuar për furnizimin e klientëve.

- Për sa bërë me dije nga shoqëria që do të sigurojë energjinë elektrike për rishitje te mjediset e vetë shoqërisë dhe klientët e rezidencës, do t’i kërkohet shoqërisë të saktësojë klientët që parashikon të furnizojë, pasi aktualisht detyrimin e shërbimit publik për klientët familjarë e ka Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “H&K@Vala Mar Residences” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti